



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.1435/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Komisioni i Pavarur i Mediave, me seli ne Prishtinë rr. “Perandori Justinian” nr.124, ndaj debitorit “KLAN KOSOVA” shpk, me NUI 810795297 dhe nr. Biznesi 70542943, me seli ne Prishtinë “Zona Industriale-Ish Fabrika e Amortizatorëve”, duke vendosur sipas ankesës së kreditorit, te paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2626/22 dt.19.06.2023, me datë 13.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e kreditorit Komisioni i Pavarur i Mediave, me seli ne Prishtinë rr. “Perandori Justinian” nr.124, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2626/22 i datës 19.06.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkalles se Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPP.nr.2626/22 dt.19.06.2023, ka aprovuar si te bazuar prapësimin e debitorit “KLAN KOSOVA” shpk, me seli ne Prishtinë, ndërsa e ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.512/22 dt.06.10.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj me seli ne Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi, ne afat ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, me te cilin e atakon ne tërësi aktvendimin e atakuar dhe propozon që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj si të bazuar këtë ankesë dhe aktvendimin e atakuar ta anuloj.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Komisioni i Pavaruri Mediave, me seli ne Prishtinë rr. “Perandori Justinian” nr.124, me datën 05.10.2022 ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit “KLAN KOSOVA” shpk, me NUI 810795297 dhe nr. Biznesi 70542943, me seli ne Prishtinë “Zona Industriale-Ish Fabrika e Amortizatorëve”, në bazë të dokumentit përmbarrues Vendim nr. ref.2112/1482/KPM/XHL dt.,21.12.2021, lidhur me rastin nr.2021/313 lëshuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM).

Përmbarruesi Privat Destan Bujupaj Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbarrim, ka lejuar përmbarrimin me urdhrin përmbarrimor P.nr.512/22 dt.06.10.2022, përmes se cilit debitori detyrohet që kreditorit t’ia paguaj detyrimin sipas këtij vendimi ne shumën prej 1,000.00 (njëmijë) euro.

Kundër këtij urdhri, debitori ka paraqitur prapësim, me arsyetimin se urdhrin përmbarrimor nuk i është bashkangjitur asnjë provë se vendimi i shkallës se parë më sanksion gjobën në shumën 1,000.00 euro është bërë i plotfuqishëm, andaj konform neni 71 te LPP nuk ka pasur arsye ligjore te shkohet me procedurën e përmbarrimit meqë për debitorin nuk kanë qenë te njohura rrethanat e plotfuqishmërisë së vendimit, propozon qe gjykata ta aprovoj si te bazuar prapësimin dhe urdhri përmbarrimor te anulohet ndërsa procedura te kthehet ne gjendje fillestare dhe te detyrohet kreditori ta dëshmoj borxhin e kërkueshëm.

Përgjigje ne prapësimin e debitorit ka ushtruar kreditori, me arsyetimin se urdhri për përmbarrim është ne pajtim me dispozitat ligjore nga neni 21, 22 dhe 23 te LPP, sepse është lëshuar mbi një vendim administrativ te formës e prerë, kreditori kundërshton ne tërësi pretendimet e debitorit dhe vlerëson se nuk ekziston asnjë nga shkaqet ligjore te parapara me nenin 71 te LPP, propozon qe gjykata ta refuzojnë prapësimin e debitorit si te pabazuar dhe urdhri përmbarrimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhoma e Shkallës se Parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe shkresave ne lëndë, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.2626/22 dt.19.06.2023, me të cilin e ka aprovuar prapësimin e debitorit dhe ka anuluar urdhrin përmbarrimor, duke vendosur si në dispozitiv të njëjtit. Në arsyetim të aktvendimit gjykata i është referuar neni 21 dhe neni 36 par.1 te LPP, dhe konsideron se aktvendimi nr.ref.2112/1482/KPM/XHL dt.,21.12.2021, mbi bazën e te cilit është lejuar përmbarrimi nuk ka tipare te përmbarrueshmërisë përkatësisht nuk i plotëson kushtet ligjore për tu përmbarruar sipas neni 24 par.3 dhe neni 36 te LPP, i njëjti nuk përmban klauzolën e përmbarrueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri përmbarrimor duhet të anulohet, ashtu qe vendosi si ne dispozitiv te këtij aktvendimi.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj vendimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm,

për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kjo gjykatë vlerëson, se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë me rastin e vendosjes, sepse në këtë rast urdhri përmbartimor i përmbartuesit privat mbetet i pa ekzekutueshëm, pra dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar përmbartimi përkatësisht vendimi nr. ref.2112/1482/KPM/XHL dt.,21.12.2021, i lëshuar nga Komisioni i Pavarur për Media në Kosovë, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë titull ekzekutiv siç parashihet me dispozitat ligjore të nenit 22 par.1 nenpar.1.2 dhe nenit 36 par.1 i LPP-së i cili përcakton se: *“Se bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmërisë për përmbartueshmëri”* dhe par.2 i cili parasheh që *“Vërtetimin për përmbartueshmëri e jep Gjykata respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, sepse dokumentit mbi bazën e të cilit është lejuar përmbartimi i mungon i klauzola e përmbartueshmërisë për përmbartueshmëri, andaj bazuar edhe në nenin 24 par.3 të LPP i cili parasheh që *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbartimor, po që se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”*, del se ky dokument si i tillë siç i është bashkuar propozimit për përmbartim nuk i përmbush kushtet e parapara ligjore për lejimin e përmbartimit.

Gjykata i analizoj dhe shqyrtoj edhe pretendimet ankimore të kreditorit por vlerësoj se provat e reja tani nuk mund të merren parasysh, për një vendosje ndryshe andaj i refuzoi si të tilla ndërsa aktvendimin e atakuar e vërtetoj.

Përndryshe, në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1435/23 me datë 13.05.2024

Gjyqtari

Krenar Berisha